



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL BASHKIA VAU DEJËS

Nr 4612 Prot.

Vau Dejës, me 07/08/2020

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 18, ligjin nr.22/2018” për strehimin social, për vënien në zbatim të programeve të strehimit nga Bashkia Vau Dejës, në bashkëpunim ndërmjet Sektorit të Shërbimit Social dhe Këshillit Bashkiak Vau Dejës: **Njoftojmë se me datë 27/08/2020, ora 11:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Njesisë Administrative Bushat, ftojme në dëgjese publike të gjithë banorët dhe grupet e interesuara për të diskutuar rreth problematikave dhe vështirësive që kanë banorët rreth strehimit në territorin e Bashkisë Vau Dejës.

Dëgjesa kryhet për të bërë një vlerësim të thelluar në mënyrë që të aplikohen programet e duhura të strehimit për të përmbushur kërkesat e parashtruara.

Gjithashtu do të diskutohet rreth sistemit të pikëzimit që do të aplikohet për çdo program për të cilin shfaqet interes gjatë takimit.

Ftohen çdo individ që është banor i Bashkisë Vau Dejës, që ka mbushur moshën 18 vjeç i cili nuk ka banesë ose zotëron një sipërfaqe banimi nën normat e strehimit sipas përcaktimeve ligjore ose ka mbetur i pastrehë për shkak të përcaktuara në ligj, ose ka të ardhura të pamjaftueshme për të përballur shpenzimet e strehimit të përshtatshëm sipas përcaktimeve ligjore.

SEKRETARI KËSHILLIT

Ardian ÇELEPIJA



P/SEKTORIT TË SHËRBIMIT SOCIAL

Çuka BABANI